

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
MISIONI NË KOSOVË**

**Përbërja Gjinore e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në  
Kosovë  
(2010)**

**Edicioni 10  
Dhjetor 2010**

## Përmbledhje Ekzekutive

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE) ka shqyrtuar përbërjen gjinore të emërimeve për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë që janë bërë në vitin 2010. Një Komision i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) ishte themeluar në vitin 2008 dhe për detyrë kishte të vlerësonte përshtatshmërinë e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në Kosovë.<sup>1</sup> Këto emërime përfshijnë gjyqtarë e prokurorë të rinj dhe ri-emërim të atyre që kanë mbajtur vendet për mandat të ri. Përafërsisht 246 gjyqtarë dhe 88 prokurorë janë emëruar apo ri-emëruar në vitin 2010.<sup>2</sup> Ky raport shqyrton përbërjen gjinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga fundi i vitit 2009 deri menjëherë pas procesit të emërimeve që përfundoi në tetor të vitit 2010.

Edhe pse përbërja e përgjithshme gjinore e gjyqtarëve ka mbetur e pandryshuar me 28 për qind femra, në disa gjykata me juridiksion më të madh, siç janë gjykata e qarkut, procesi i emërimit tregon një trend modest të ngritjes. Për gjykata tjera, siç janë gjykatat komunale, në përgjithësi ka pasur trend të uljes. Megjithatë, brenda gjykatave komunale, përqindja e kryetareve të gjykatave u ngrit prej 13 në 32. Përbërja e përgjithshme gjinore për prokurorë u ngrit prej 24 në 30 për qind femra, pa asnjë kryeprokurore komunale në vitin 2009, në 29 për qind kryeprokurore komunale, pas emërimeve të vitit 2010. Ky është një trend tjetër në ngritje.

OSBE lavdëron progresin që është arritur në drejtim të bilancit gjinor por është e brengosur se barazia gjinore, madje as siç është e definuar me kornizën ligjore në Kosovë, nuk është arritur në të gjitha gjykatat.

## Standardet Ndërkombëtare

E drejta për mundësi të barabarta për mbrojtje nga diskriminimi, pa marrë parasysh gjininë, gjendet në një numër konventash ndërkombëtare, tri nga të cilat janë të identifikuar këtu.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike (KNDCP) garanton “të drejtën dhe mundësinë [...] për të marr pjesë në kryerje të punëve publike”<sup>3</sup> dhe kërkon që “[s]jecila [...] Palë në këtë Konventë të ndërmerr hapa për të respektuar dhe për t’i siguruar të gjithë individëve brenda territorit dhe juridiksionit të vet, të drejtat e njohura me këtë Konventë, pa kurrfarë dallimi të çfarëdo lloji siç është raca, ngjyra, gjinia, gjuha, religjioni, mendimi politik apo ndonjë tjetër, origjina shoqërore apo kombëtare, prona, lindja apo ndonjë status tjetër.”<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> Misioni i Përkohshëm i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Urdhëresa Administrative Nr. 2008/2, 17 janar 2008, Neni 1.1, themeloi Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJK) “me qëllim të drejtimit të një shqyrtimi gjithëpërfshirës mbarëkosovar të përshtatshmërisë së të gjithë aplikantëve për emërime të përhershme... për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët.... Në përfundim të këtij procesi, rekrutimi dhe përzgjedhja e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë do të bëhet në pajtim me të gjitha ligjet tjera në fuqi.”

<sup>2</sup> Të gjitha të dhënat statistikore për gjyqtarë dhe prokurorë janë dhënë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe janë mbledhur nga monitoruesit e gjykatave të OBSE-së gjatë intervistave me Kryetarë të Gjykatave, Administratorëve të Gjykatave dhe bashkëbiseduesve tjerë relevant gjyqësor. Veç kësaj, referencat për Kryetarë të Gjykatave dhe Krye-Prokurorë përshijnë edhe ata që ushtrojnë detyrën deri në emërim të përhershëm.

<sup>3</sup> Shih Nenin 2.1, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP).

<sup>4</sup> Ibid, Neni 25.

Për më shumë, Neni 14 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ)<sup>5</sup> ndalon diskriminimin “[...]mbi çfarëdo baze siç është gjinia, raca, gjuha, religjioni, mendimi politik apo ndonjë tjetër, origjina shoqërore apo kombëtare, prona, lindja apo ndonjë status tjetër.”

Së fundmi, Neni 7 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (KEDKG)<sup>6</sup> kërkon që institucionet përkatëse “të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin kundër grave në jetën politike dhe publike të vendit.”<sup>7</sup> Komiteti i KB-ve për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, në Rekomandimin e vet të Përgjithshëm 23, është i qartë se pjesëmarrja në “jetën politike dhe publike” përfshin pjesëmarrjen në të gjitha “funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë.”<sup>8</sup>

### Korniza ligjore e Kosovës

Institucionet e Kosovës kanë përfshirë ligjin ndërkombëtar relevant që ka të bëjë me barazi gjinore në kornizën e vet ligjore vendore. Neni 22 i kushtetutës pranon zbatimin e drejtpërdrejtë të një numri instrumentesh e marrëveshjesh ndërkombëtare, përfshirë KEDNJ-në, KNDCP-në, dhe KEDKG-në.<sup>9</sup> Neni 7 përshkruan barazinë gjinore në kuptim të vlerave fundamentale: “...Kosov[a] siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.”

Ligje tjera përmbajnë dispozita që kanë të bëjnë me barazinë gjinore.<sup>10</sup> Në veçanti Ligji mbi Barazinë Gjinore<sup>11</sup> që hyri në fuqi me 1 korrik 2007 ka për qëllim që të “mbrohet, trajtohet dhe vendoset, barazia ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore.”<sup>12</sup>

Ky ligj definon barazinë gjinore si “pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, [sic] pozitivisht të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e

<sup>5</sup> Shih Nenin 14, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale (KEDNJ).

<sup>6</sup> Konventa për Eliminimin të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (KEDKG).

<sup>7</sup> Ibid, Neni 7.

<sup>8</sup> Komiteti i KB-ve mbi Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW Orig.), Rekomandimi i Përgjithshëm i CEDAW Nr. 23: Neni 7 i Konventës (Gratë në Jetën Politike dhe Publike), 1997, seanca e 16<sup>te</sup>, e qasshme në: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm#recom23>. (e qasar me 11 nëntor 2010).

<sup>9</sup> Neni 22(2), (3) dhe (6) i kushtetutës së Kosovës.

<sup>10</sup> Shih Ligjin Nr. 2004/03, Ligji kundër Diskriminimit, 19 shkurt 2004, e shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/32, 20 gusht 2004: “..Parimin e trajtimit të barabartë që nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore... lindjes ose staturave tjera.” Neni 2(a); Ligji Nr. 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës: “Të gjithë personat gëzojnë trajtim të barabartë të të drejtave dhe detyrimeve të parapara me këtë Ligj. Nuk do të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ndaj asnjë personi apo personave në bazë të gjinisë, moshës, gjendje martesore...lindjes apo gjendjes tjetër.”

<sup>11</sup> Ligji Nr 2004/2 mbi Barazinë Gjinore, 19 shkurt 2004, e shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/18, 7 qershor 2004, (por nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare deri me 1 korrik 2007).

<sup>12</sup> Ibid., Neni 1.1.

shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.”<sup>13</sup> Megjithatë, është interesante se në vend se të luftohet për bilanc pjesëmarrjeje të barabartë gjinore prej 50 për qind “[p]jesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve[...] arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40[...]”<sup>14</sup> Kjo do të thotë se, sipas kornizës ligjore në Kosovë, barazia gjinore arrihet kur përpjesëtimi i meshkujve dhe femrave është 60 dhe 40 për qind respektivisht. Për të ndihmuar që ky qëllim për përqindje gjinore të arrihet, ligji lejon që “me zbatimin e masave ligjore dhe afirmative [të] vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të [arrijë] nivelin e pjesëmarrjes së tyre të popullata e përgjithshme e Kosovës.”<sup>15</sup>

Ligji mbi Gjykatat<sup>16</sup> parasheh angazhim shtesë për barazi gjinore më kushtin e vendosur që “[p]ërbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike [...] dhe parimet e njohura ndërkombëtarisht.”<sup>17</sup>

### **Emërimi i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve**

Procesi i emërimit kërkonte që të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët të kalojnë provime dhe kontroll të dosjeve. Ata të cilët kanë përfunduar me sukses këtë proces janë emëruar (apo ri-emëruar) në pozita të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky proces i verifikimit filloi në vitin 2008 dhe përfundoi në tetor të vitit 2010. Ri-emërimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve ishin bërë në vitin 2010. Kanë mbetur përafërsisht 146 pozita të aprovuara për gjyqtarë dhe 16 pozita për prokurorë që të plotësohen me emërimet e ardhshme.

Para procesit të ri-emërimit, 28 për qind nga të gjithë gjyqtarët ishin femra (80 nga 281). Pas procesit të ri-emërimit përbërja kishte mbetur e njëjtë.

Para procesit të ri-emërimit 24 për qind nga të gjithë prokurorët ishin femra (21 nga 89). Pas procesit të ri-emërimit, proporcioni i prokurorëve femra u ngrit në 30 për qind (26 nga 88).

### **Emërimi i Gjyqtarëve**

#### **Trendet në ngritje në gjykatat speciale dhe ato të larta**

Para procesit të emërimit 43 për qind të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme, Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme, gjykatën ekonomike, dhe gjykatën e lartë për kundërvajtje ishin femra (9 nga 21). Pas procesit të emërimit proporcioni i gjyqtarëve në këto gjykata u ngrit në 48 për qind (11 nga 23). Para procesit të emërimit, 21 për qind e gjyqtarëve në gjykatat e qarkut ishin femra (10 nga 48). Pas procesit të emërimit proporcioni i femrave në këto gjykata u ngrit në 26 për qind (12 nga 46).

Para procesit të ri-emërimit Gjykata Supreme, Gjykata Ekonomike, dhe Gjykata e Lartë për Kundërvajtje nuk kishin kryetare femra. Pas procesit të emërimit dy nga tre kryetarë ishin

---

<sup>13</sup> Ibid., Neni 2.1.

<sup>14</sup> Ibid., Neni 3.2.

<sup>15</sup> Ibid., Neni 3.1.

<sup>16</sup> Ligji Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat, e aprovuar me Dekretin Nr. DL-047-2010, e datës 09.08.2010, e shpallur me Gazetën Zyrtare të Kosovës Nr 79, 24 gusht 2010. Neni 43 parasheh se “[k]y Ligj hyn në fuqi më 1 janar 2011 për nenet 29, 35, 36, 38 dhe 40, kurse për nenet e tjera fillon të zbatohet nga 1 janari 2013.”

<sup>17</sup> Ibid., Neni 5.

femra. Para procesit të emërimit kishte 13 për qind (3 nga 24) kryetare në gjykatat komunale. Pas procesit të emërimit u ngrit në 32 për qind (7 nga 22) kryetare.

#### **Trendet në ulje në gjykatat komunale dhe për kundërvajtje**

Para procesit të emërimit 27 për qind e gjyqtarëve në gjykatat komunale ishin femra (34 nga 126). Pas procesit të emërimit proporcioni i gjyqtarëve femra këto gjykata u ul në 25 për qind (30 nga 121). Para procesit të emërimit 31 për qind e gjyqtarëve në gjykatat për kundërvajtje ishin femra (27 nga 86). Pas procesit të emërimit proporcioni i gjyqtarëve r në këto gjykata u ul në 29 për qind (16 nga 56).

Para procesit të emërimit 36 për qind e kryetarëve të gjykatave për kundërvajtje ishin femra (9 nga 25). Pas procesit të emërimit proporcioni i femrave kryetare u ul në 17 për qind (4 nga 23).

#### **Pa Ndryshim në gjykatat e qarkut**

Pesë gjykatat e qarkut, të gjitha menaxhoheshin nga kryetarë meshkuj në vitin 2009 dhe 2010.

### **Emërimi i Krye-Prokurorëve në Zyrat Komunale dhe të Qarkut**

#### **Trendet në ngritje me krye-prokurorë komunal**

Para procesit të emërimit nuk ka pasur kryeprokurore komunale në vitin 2009. Pas procesit të emërimit kishte një ngritje të konsiderueshme prej 29 për qind (2 nga 7) kryeprokurore komunale.

#### **Pa ndryshim me krye-prokurorë të qarkut**

Të gjithë kryeprokurorët e qarkut në vitin 2009 dhe 2010 ishin meshkuj.